



E Ngarkuara e Qeverisë Federale
për Migracionin, Refugjatët
dhe Integrimin

ÇFARË DUHET TË DINI TANI MBI KORONAN

Këshilla për sjelljen, kodi i punës dhe rregullat
në lidhje me udhëtimin me një shikim

Shëndeti



SI MUND TË MBROJ VETEN DHE TË TJERËT?

Të gjithë mund të ndihmojnë, që koronavirus të mos përhapet shumë shpejt. Qëndroni mundësisht në shtëpi. Keni sa më pak kontakt të jetë e mundur me njerëzit, me të cilët nuk banoni bashkë. Vetëm kështu mund të mënjanonin infektimin. Përveç të tjerave është e rëndësishme:



**QË TË LANI DUART
(MINIMUMI PËR
20 SEKONDA)**



**MBANI TË 1,5 METRA
DISTANCË KUNDREJT
NJERËZVE TË TJERË.**



**MBANI NJË MBULESË PËR
GOJËN DHE HUNDËN.**



**PËR KË ËSHTË VEÇANËRISHT
I RREZIKSHËM VIRUSI?**


- për njerëzit me sëmundje të mëparshme (p.sh. sëmundje të zemrës dhe të enëve të gjakut, diabet, sëmundje të sistemit të frymëmarrjes, të mëlçisë dhe të veshkave si dhe kancer);
- për pacientët me një sistem imunitar të dobësuar (për shkak të një sëmundje ose për shkak të medikamenteve si kortizoni);
- për të moshuarit.



**ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE BESOJ
SE JAM INFEKTUAR?**

Keni pasur kontakt personal me një person, te i cili u vërtetua që ishte i infektuar me koronavirus? Atëherë telefononi menjëherë zyrën tuaj lokale të shëndetit! Edhe atëherë, nëse nuk dallohen shenja të sëmundjes. Zyra e shëndetit ju shpjegon se si mund të testoheni. Deri sa të mbërrijë rezultati, duhet që të qëndroni në shtëpi.

JETA PUBLIKE



ÇFARË DO TË NDODHË ME KOPSHTET, SHKOLLAT DHE DYQANET?

Dyqanet lejohet që të qëndrojnë të hapur, nëse ato përbushin disa kushte të caktuara. Për shembull ato do lejohen që të lenë që të futen brenda një numër maksimal i caktuar personash, në mënyrë që të ruhet distanca e mjaftueshme. Edhe mbajtja e një mbulese për gojën dhe hundën mund të përfshihet te këto masa. Në kopshte për shembull mund të rifillojë kujdesi për fëmijët, të cilët kanë nevoja të veçanta për

nxitjen e të folurit ose që nuk kanë një dhomë vetjake. Shkollat do të rifillojnë përsëri hap pas hapi. Për këtë gjë landet federale do të rregullojnë detajet.



SA KONTAKT LEJOHET ME NJERËZIT E TJERË?

Jashtë shtëpisë ose banesës tuaj ju lejohet që të lëvizni i vetëm – ose me njerëz, me të cilit ju jetoni në një banesë. Ju lejoheni të takoheni edhe me persona të një familje tjetër, nëse respektoni një distancë prej 1,5 m.

Se çfarë do lejohet përtej kësaj, do të rregullohet nga landet federale – edhe rregulla më të rrepta mund të jenë të mundura. Ju lutemi informohuni në internet në faqen e qeverisë përkatëse të landit.



JASHTË JU LEJOHENI QË:

- Të shkoni në punë;
- Të dërgoni fëmijët tuaj për te kujdesi i detyrueshëm;
- Të kryeni blerje ose të shkoni për vizitë te mjeku;
- të merrni pjesë në mbledhje, takime të domosdoshme dhe provime;
- të ndihmoni të tjerët ose të lëvizni në ajër të pastër ose të bëni sport.

Puna dhe paratë



ÇFARË NDODH, NËSE PUNËDHËNËSI IM E MBYLL AKTIVITETIN PËR SHKAK TË KORONAS?

Normalisht ju vazhdoni të posedoni të drejtën për tu trajtuar me pagë, edhe nëse ju nuk mund të punoni.

ÇFARË DUHET TË BËJ, NËSE NGELEM PA PUNË?

Në rast se ngeleni pa punë duhet që të regjistrohemi në Jobcenter-in tuaj ose zyrën tuaj të punës. Jobcenter dhe zyrat e punës vazhdojnë të punojnë, por nuk presin vizita. Ju mund të regjistrohemi si i papunë me telefon, duke shkruar një letër ose online dhe ti parashtroni të gjitha kërkesat online. E rëndësishme është: Edhe gjatë kohës së koronas vlejnjë rregullat e mbrojtjes kundrejt pushimit nga puna.



ÇFARË NDODH, NËSE PUNËDHËNËSI IM KA URDHËRUAR PUNË ME ORAR TË SHKURTUAR?

Nëse punëdhënësi juaj ka urdhëruar në mënyrë të drejtë punën me orar të shkurtuar, atëherë deri në dymbëdhjetë muaj ju mund të përfitoni pagesën për punën me orar të shkurtuar. Mund të

jetë deri në 87% të pagës tuaj të munguar. Nëse janë përbushur të gjitha kushtet për pagesën e punës me kohë të shkurtuar, kontrollohet për çdo rast nga agjencia e punës.



ÇFARË NDIHMASH MUND TË MARR PËR NDËRMARRJEN TIME?

Instituti kreditor për rindërtim (KfW) ofron kredi të ndryshme të favorshme për ndërmarrjet. Ju lutemi drejtojuni bankës tuaj ose partnerëve të financimit, të cilët akordojnë kreditë e KfW.

ÇFARË MBËSHTETJE MARRIN TË VETË-PUNËSUARIT ME NJË PERSON DHE BIZNESI I VOGËL?

Të vetë-punësuarit me një person dhe bizneset e vogla mund të aplikojnë në landin e tyre federal për një subvencion për tre muaj, për të tejkaluar problemet me likuiditetin. Kemi të bëjmë me një pagesë të njëhershme prej deri në 9.000 € në rastin kur kemi deri në pesë të punësuar ose deri në 15.000 € në rastin kur kemi deri në dhjetë të punësuar. Landet federale posedojnë programe plotësues.



ÇFARË NDODH NËSE PËR SHKAK TË KRIZËS SË KORONAS UNË NUK MUND TA PAGUAJ MË QIRANË TIME?

Nuk lejohet prishja e kontratave për banesat dhe ambientet e biznesit, nëse për shkak të krizës së koronas do ketë vonesa në pagesën e qirasë. E njëjta gjë vlen edhe për energjinë elektrike, gazin dhe telefonat. Nëse për shkak të pasojave të krizës së koronas, ndërmjet datës 1 Prill dhe 30 Qershor 2020 ju keni borxhe të qirasë, qiradhënësit nuk lejohen që t'ju prishin juve kontratën. Ju keni mundësinë që qiranë e papaguar ta paguani më vonë deri në fund të Qershorit 2022. Për

qiramarrëset dhe qiramarrësit për arsye biznesi, të cilët janë të vetë-punësuar, nga ana e qeverisë qendrore dhe e landeve do të ketë subvencione financiare për shpenzimet e ndërmarrjes.



MUND TË PARASHTRONJ KËRKESËN PËR NJË SHITESË PËR FËMIJËT?

Nëse të ardhurat mjaftojnë vetëm për ju vetë, por jo për të gjithë familjen, ju ndoshta mund të përfitoni shtesën për fëmijët. Në këtë periudhë kohore kontrollohen në rastin e kërkesave të reja vetëm të ardhurat e muajit të fundit. Ky rregull ka një afat të caktuar.



UDHËTIMET BRENDA DHE JASHTË VENDIT

MUND TË UDHËTOJ PËR NË ATDHEUN TIM? MUND TË KTHEHEM NË GJERMANI?

Në përgjithësi vlen: Udhëtimet që nuk janë të domosdoshme nuk duhen kryer. Ju lutemi informohuni para se të ndërmerrni udhëtimin mbi kufizimet aktuale të udhëtimit dhe udhëzimet mbi kontrollat e përkohshme në kufi. Për shkak të gjendjes dinamike, ndryshimet e rregullave aktuale mund të bëhen të domosdoshme në një kohë të shkurtër.



ÇFARË BËN QEVERIA?

Masat e qeverisë federale dhe e landeve duhet të ndihmojnë që të kufizohet përhapja e virusit. Një shtab krizash i qeverisë federale përgatit masat, për frenimin e koronavirusit dhe për mbrojtjen e popullsisë. Përveç të tjerave qeveria federale ka miratuar një paketë të gjerë masash me vlerë prej rreth 750 miliard Eurosh, për të zbutur pasojat ekonomike.



KU MUND TË GJEJ INFORMACIONE TË BESUESHME MBI KËTO TEMA NË GJUHË TË NDRYSHME?

Interneti është plot me thashetheme dhe fake news, të cilat përhapen me shpejtësi nëpërmjet chat-eve në grup. Informacione aktuale në gjuhë të ndryshme, të cilave ju mund ti zini besë, gjeni në: www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus dhe www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus.

Botuesi:

E Ngarkuara e Qeverisë Federale për Migracionin, Refugjatët dhe Integrimin;

Versioni:

06.05.2020



www.integrationsbeauftragte.de/corona-virus



www.eu-gleichbehandlungsstelle.de/corona-virus